

## NË EMËR TË POPULLIT!

Gjykata Themelore Ferizaj- Dega në Kaçanik , Departmenti i përgjithshëm përmes gjyqtarit të vetëm gjykues Shabi Idrizi , sek. Juridike, Shpresa Hoxha, në qeshtjen penale të akuzuarit [REDACTED] nga Shkupi dhe [REDACTED] nga fshati [REDACTED] Komuna e Kaçaniku, të akuzuar për shkak të veprës penale, rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par 6 lidhur me par.1 të KPK-së, sipas aktakuzës, së Prokuroris themelore në Ferizaj PP/II.nr.883-1/14 të datës 08.01.2015, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësorë oral dhe të hapur më dt. 27.12.2016 në prezencë të Prokurorit Shtetëror Agim Kuka,të akuzuarit [REDACTED] dhe në mungesë të akuzuarit [REDACTED] ( i është veçaur lenda) , muarr dhe të njenjtën ditë shpalli publikisht këtë:

### A K T G J Y K I M

I akuzuari [REDACTED] nga babai [REDACTED] dhe nëna [REDACTED] e gjinisë [REDACTED] , i lindur [REDACTED] në Kaçanik,me vendbanim në f. [REDACTED] pregaditja shkollore shkolla fillore ,i pa punë,i gjendje së varfër ekonomike,i martuar, pa shënime se më pare ka qenë i denuar , shqiptar, nënshtetas kosovar NP. [REDACTED]

### ËSHTË FAJTOR

Se me datë 27.03.2014, rreth orës 11:10 në magjistralen Kaçanik-Hani Elezit , i pandehuri i parë duke drejtuar automjeitin transportues Volvo me targa [REDACTED] ndërsa i pandehuri i dytë duke drejtuar automjetin "Lada Niva "., me targa [REDACTED] në kundërshtim me dispozitat e LSKRR-se nga pakujdesia secili ka rrezikuar jetën e njerëzve dhe të pasurisë në atë mënyrë që, i pandehuri i parë me të arritur tek vendi i quajtur "Te kulla me qeshmë " , ndal automjetin transportues në shiritin e tij të lëvizjes për shkak të një defekti në automjet , ndërsa i pandehuri i dytë i cili ishte duke lëvizur pas tij pa u siguruar mirë hynë në anashkalim ku gjatë këtij veprimi me pjesën e përparme të anës së djathtë godet automjetin transportues "Volovo", ne dy rrotat e pasme të anës së majtë kalon në shiritin e kundërt të lëvizjes ku në ato momente nga drejtimi i kundërt ishte duke qarkulluar automjeti "Peugeot 407", të cilën e drejtonte [REDACTED] i cili për shkak të distancës shumë të shkurtër dhe në pamundësi që ta ndal veturën me pjesën e përparme të veturës godet automjetin "Lada " , në pjesën e majtë të pasme nga ky aksident lëndime trupore pësojnë [REDACTED] dhe [REDACTED] . Lëshimet e të pandehurit të parë janë sekondare ndërsa të pandehurit të dytë janë primare.

Me këtë veprim ka kryer veprën penale rrezikim i trafikut publik nga nenin 378 par 6 lidhur me par 1 të KPK-së.

-andaj gjykata në bazë të nenit 3 ,41, 50,51,75 të KPK-së dhe nenit 365, 453 të KPPK-së i shqipton

## DENIM ME KUSHT

Të akuzuarit [REDAKTUAR] nga fshati [REDAKTUAR] i shqipton denim me burg në kohëzgjatje prej 90(nëntëdhjet) ditëve i cili nuk do të ekzekutohet po që se në afat prej një viti (koha e verifikimit)pas plotfuqishmërisë të këtij aktgjykimi nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale.

Udhëzohen të dëmtuarit që kërkesen pasurore juridike ta realizojnë në contest civil.

Obligohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve procedurale të paguaj paushallin gjyqsor në shumë prej 50.00 € .

## A r s y e t i m

PTH nga Ferizaji, me Aktakuzën . PP/II.nr.883-1/14 të datës 08.01.2015, të akuzuarin [REDAKTUAR], e ka akuzuar për shkak veprës penale rrezikimi I trafikut publik nga neni 378 par 6 lidhur me 1 të KPK-së.

Në shqyrtimin gjyqsor Prokurori shtetror pranë PTH-Ferizaj Agim Kuka në fjalën përfundimtare mbeti në tërsi pranë aktit akuzues së paraqitur me shkrim pranë kësaj gjykate pa ndryshime dhe plotsime, duke propozuar gjykatës që të akuzuarin [REDAKTUAR] të e shpall fajtor për veprën penale që akuzohet dhe ti shqiptohet denim meritior sipas ligjit . Njiheri i ka propozuar gjykatës që gjatë matjes së denimit ti ketë parsysh si rrethanat lehtsuese pranimin e fajsisë, pendimin e thellë të tij , bashkpunimin me gjykatën-prokurorin për zbardhjen së të vërtetës .

I akuzuari [REDAKTUAR] në mbrotjen e tij në shqyrtimin gjyqsor në tërsi e ka pranuar kryerjen e veprës penale që i vëhet në barrë sipas aktakuzës dhe njiherit është penduar për këtë vepër penale dhe propozon që gjykata të ia shqipton një denim sa më të butë dhe premtion se do jetë shumë më i kujdeshëm dhe se prej asaj kohe nuk ka kurrfarë veprimi tjetër inkriminues.

Pasiqë gjykata ka fituar bindjen se i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajit për veprën penale që i vëhet në barrë dhe është e bindur se pranimin e kanë bërë në baza vullnetare duke u mbshtetur në nenin 326 lidhur me 248 par 4 të KPPK edhe në faktet dhe provat që përmban akti akuzues por edhe ne shkresat e lëndës, ka gjetur se janë përmbushur kushtet ligjore nga neni 248 par 4



të KPPK-së dhe shqyrtimin gjyqsor e ka përfunduar pa adminstrimin e provave tjera.

Gjykata vleron se në veprimet e të akuzuarit ekzistojnë të gjitha tiparet e veprës penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par 6 lidhur me 1 të KPK-së për të cilën veprë i akuzuari është penalishtë përgjegjës dhe është ndeshkuar si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Me rastin e matjës së denimit gjykata i ka pasur parasysh të gjitha rrethanat nga neni 75 dhe 76 i KPK-së të cilat ndikojnë në zbutjen apo ashpërsimin e dënimit. Si rrethanë lehtësuese për të akuzuarin gjykata ka marrë për bazë pranimin e fajit nga i akuzuari, pendimin e tij, sjelljen e mirë të tij gjatë tërë procedurës si dhe në shqyrtimin - fillestar -gjyqsor,kurse për bazë për llojin dhe lartsin e denimit ka marrë parashysh se ai më pare nuk ka qenë i gjykuar, ndërsa rrethanë rënduese se kjo veper penale paraqet rrezikshmeri të lartë për pjesmarrsit në komunikacion.

Gjykata është e bindur se denimi i shqiptuar ndaj të akuzuarit është në harmoni me shkallën e pergjegjsise penale të tij dhe peshën e vepres penale, keshtu që denimi i shqiptuar në lartësi si në dispozitiv të aktgjykimit , do arrihet qëllimi i denimit i paraparë me nenin 41 të KPK-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës është i mbshtetur në dispozitën e nenit 453 dhe kurse për udhizimin e pales së dëmtuar në contest civil conform nenit 463 të, KPPK-së ,

Nga të cekurat e mësipërme u vendos si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NE FERIZAJ-Dega në Kaçanik**  
**P. nr. 9/15, me dt. 27.12.2016**

Sek. Juridike,  
Shpresa Hoxha

Gjyqtari,  
Shabi Idrizi

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi , pala e paknaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë permes kësaj gjykate.

